

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Jo revoltë kundër Merzit, por shumë pakënaqësi në prapaskenë
ADRESA	https://tpz.al/jo-revolte-kunder-merzit-por-shume-pakenaqesi-ne-prapaskene-i333700
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:01:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 15:17:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	59b0486d288f8e151b205e8c62fce62226878aa78e8f7684728e688b9afe1e00
TEKSTI	2cc6ca6665249a89d33732c7a132fbfaf9698ee46413fd56a4c01c90d656d6b4
PAMJA	fe273e0a4946eb4d551d307fbc688008e34ba9035953f1fb50899738aee2c062

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a7f0ac6257bec4476860f72b97ee771105468eb64b747dc8d40619e86a55cc06
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a7f0ac6257bec4476860f72b97ee771105468eb64b747dc8d40619e86a55cc06>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

20:24 Arrestohet në Rusi Salvadore Aliu, një nga personat më të kërkuar nga drejtësia shqiptare • 20:03 Moska refuzon armëpushimin, Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftin

BOTA, 23 SEPTEMBER 2026, 17:17

Jo revoltë kundër Merzit, por shumë pakënaqësi në prapaskenë

tpz.al TPZ



Kancelari Friedrich Merz do duhej të ishte në Nju Jork, në Kombet e Bashkuara ku zhvilloheshin punimet e Asamblesë së Përgjithshme. Por ai e anuloi udhëtimin në SHBA për t'u marrë me pasojat e rezultateve të dobëta zgjedhore që partia e tij, CDU pësoi fundjavën e kaluar në Mecklenburg-Vorpommern dhe Berlin.

Të martën pasdite (22.09) u mbledhën deputetët e CDU-së dhe CSU-së për të debatuar pas rezultatit historikisht të dobët në zgjedhjet e Meklenburg-Pomeranisë dhe Berlin, në një atmosferë të rëndë, siç u tha.

Në media madje flitej këto ditë për "muzgun politik" të kancelarit. Disa përshpërisnin edhe për një revoltë të mundshme brenda grupit parlamentar. Por revoltë nuk pati. Nga qarqet e CDU thuhet, se atmosfera e takimit nuk ishte e lehtë pas humbjes së rëndë zgjedhore të CDU. Deputetët thanë se Merz edhe njëherë në takimin e grupit parlamentar të Unionit kërkoi të vazhdohej kursi i reformave. Daniela Ludwig, ish-e ngarkuar e qeverisë federale për çështjet e drogës nga radhët e CSU-së, ngriti një pyetje retorike: "Po çfarë do të përmirësonte një revolucion?", duke shtuar, se "revolucionet deri më sot nuk kanë ndryshuar kurrë asgjë për mirë", sipas mediave.

"Kancelari mbetet"

Kurse deputeti i CDU-së nga Saksonia e Poshtme, i pyetur për kancelarin, u përgjigj menjëherë: "Kancelari mbetet." Sipas tij, për këtë nuk ka asnjë dyshim. "Por kancelari me siguri e ka kuptuar gjithashtu se duhet të ndryshojmë disa gjëra. Dhe pikërisht për këtë ai tha se duhet të shohim drejt së ardhmes." Kreu i grupit parlamentar, Thorsten Frei është i mendimit të shikohet tanimë drejt së ardhmes. Para mbledhjes me kancelarin, ai analizoi situatën: "Zgjedhjet e fundjavës nuk ishin thjesht zgjedhje proteste." Frei shtoi, se "përtej kësaj, ato treguan edhe se ka boshllëqe në trajtimin e disa çështjeve tematike. Me këtë duhet të merremi, duhet ta pranojmë dhe prej saj duhet të nxjerrim mësimet e duhura."

Serap Güler, deputete e CDU-së nga Renani Veriore-Vestfali, e përshkruan kështu rrugën që

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur

Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

kancelari synon të njeke. mendoj se, nga njera anë, benet iare per çeshtjen e drejtësisë sociale. Kancelari federal e bëri të qartë edhe pas mbledhjeve të forumeve drejtuese se në vendin tonë ka shumë njerëz që ndihen të lënë pas dore, që ndihen të përjashtuar nga proceset. Këtyre njerëzve duhet t'u drejtohem me mirë dhe t'i përfshijmë sërish edhe politikisht." Nga ana tjetër, sipas saj, u bë fjalë edhe për reformat: "Ne po zbatojmë reforma në mënyrë që vendi të mbetet i aftë për të përballuar të ardhmen edhe pas 30 vjetësh dhe që të ruhet drejtësia mes brezave."

[Shiko të tjera video](#)

Theksohet uniteti

Por si mund të vazhdohet kursi i reformave dhe njëkohësisht të vihet më shumë theksi te drejtësia sociale? Të harmonizohen interesat e Unionit dhe të SPD-së? Zëvendëskryetari i grupit parlamentar, Mathias Middelberg, beson se kjo është e mundur. Megjithatë, sipas tij, të gjithë janë të vetëdijshëm se kanë vetëm një mundësi: të veprojnë të bashkuar si grup parlamentar i Unionit dhe, në fund, edhe si qeveri. "Nëse tani lejojmë që të përçahemi, atëherë nuk do të dështojë vetëm kjo qeveri, por në fund do të dështojë edhe ky vend." Takimi i Unionit përfundoi pa pasoja të rënda për kancelarin. Merz mori mbështetjen e deputetëve të tij dhe kaloi një provë politike që, paraprakisht, dukej shumë më e vështirë./ DW

BOTA / 23 September 2026, 16:37

El Niño në nivele rekord, mbi 450 mijë vdekje të parashikuara nga nxehtësia, ja vendet më të rrezikuara

BOTA / 23 September 2026, 15:15

Masakër në Afrikën e Jugut! Persona të armatosur hapin zjarr në një shtëpi, 11 të vrarë, mes tyre një grua shtatzënë

BOTA / 23 September 2026, 14:47

E reja e akuzon për drogim dhe përdhunim, influencuesi 20-vjeçar rrezikon 20 vite burg nëse shpallet fajtor

BOTA / 22 September 2026, 22:55

Marrëveshje e re SHBA-Danimarkë-Groenlandë, Trump: Do ndërtojmë dy baza të mëdha ushtarake

BOTA / 22 September 2026, 21:30

BOTA / 22 September 2026, 20:52

Arrihet marrëveshja, BE zgjat sanksionet ndaj Rusisë me 3 vjet! Hiqen nga lista dy oligarkë

BOTA / 22 September 2026, 18:05

"Amerika është rikthyer"- Fjalimi i Trump në OKB: Ta asgjësoj Republikën Islamike të Iranit, t'i çoj në ferr? Teherani kurrë nuk do ketë armë bërthamore

BOTA / 22 September 2026, 16:00

Mbledhja në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Guterres paralajmëron: Çarjet janë shndërruar në kanione

BOTA / 22 September 2026, 11:31

Kryebashkiaku Mamdani sulmon sërish Netanyahu, pas takimit me Trump-in: Ai duhet të arrestohet kur të vijë në New York

F-16 rrëzohet në bazën amerikane në Gjermani, plagoset një person

BOTA / 22 September 2026, 17:21

Donald Trump në OKB: Falënderoj Shqipërinë dhe Kosovën, kanë dërguar dhe ofruar mbështetje ushtarake! Kam zgjidhur 8 luftëra

BOTA / 22 September 2026, 11:38

Bojkoti i mediave/ Shtëpia e Bardhë gjen "zgjidhje", hapet "Trump TV"

BOTA / 22 September 2026, 10:58

Negociatat/ Irani propozon rihapjen e Ngushticës së Hormuzit brenda 7 ditësh, kërkon uljen e presionit ushtarak nga SHBA

BOTA / 21 September 2026, 22:28

"Google" gjobitet me 403 milionë euro në Irlandë për përdorimin e të dhënave të vendndodhjes

BOTA / 21 September 2026, 21:40

Tragjedi pranë Kalifornisë, vdesin dy pilotë pas rrëzimit të helikopterit që luftonte zjarrin

BOTA / 21 September 2026, 21:21

Jemenasit ikin përtej Detit të Kuq, përshkallëzohen luftimet mes Houthis dhe forcave të mbështetura nga Arabia Saudite

BOTA / 21 September 2026, 20:23

Pesë "policë" rrëmbejnë një burrë në mes të rrugës në Barcelonë, dyshohet për konflikt mes grupeve kriminale (VIDEO)

BOTA / 21 September 2026, 20:13

Trump promovon marrëveshje "masive" me Bjellorusinë për plehrat, në sfondin e luftës tregtare me Kanadanë

BOTA / 21 September 2026, 19:53

Ukraina kundërshton heqjen e dy oligarkëve rusë nga sanksionet e BE-së

BOTA / 21 September 2026, 18:50

VIDEO/ Konflikt për një notë në provim, 17-vjeçarja sulmon me thikë mësuesen në një shkollë në Brazil

BOTA / 21 September 2026, 18:44

Europa po përgatitet për mundësinë e një konflikti me Rusinë

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



Built & Monetized by **Mediadesk**

AKTUALITET
IDE
NË FOKUS
BALLKAN
BOTA
LIFESTYLE

SPORT
TEJ E KETEJ
BLOG
EMISIONE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.